



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prilbëno Më/Dana		13-02-2024		Vite
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednues	
01-060	01-	133		



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr.03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28 / 15, Qershor 2008), dhe të Nenit 42, paragrafi 42.3 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011; Nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

## F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **II** të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datë **20.02.2024 (e Martë)**, në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Zyrën e Konferencave në objektin e vjetër të komunës së Vitisë.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

## R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-dhjetor 2023.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për iniciimin e procedurës për hartimin e hartës zonale të Komunës.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për plotësimin e vendimit Nr. 01-110/05-108, të datës 01.02.2022, për plotësimin-ndryshimin e vendimit për formimin e Komitetit për Komunitete me Nr. 01-110/05-974 të datës 28.12.2021.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit Nr. 01-110/05-49932 i datës 27.12.2023 për mbështetje financiare për shpenzimet e strehimores "Liria", Gjilan, për një periudhë trevjeçare, 2024-2025-2026.
6. Informatë për planifikimin përfundimtar të prokurimit për vitin 2024.
7. Informatë nga DKA-ja për përfundimin e gjysëmvjetorit të parë dhe fillimin e gjysëmvjetorit të dytë shkollor.

Viti, më 13.02.2024

Me respekt!  
Kryesuesi i Kuvendit  
Bekim Azizi





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E PARË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **19.01.2024 (e premte)** në zyrën e konferencave të objektit të vjetër të Komunës së Vitisë, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i Kuvendit Komunal), z.Illir Zuka, z.Ramadan Deliu, znj.Zejnepe Osmani, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, ndërsa mungoj, znj.Zyrafete Rama. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se prezent janë 6 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Përshëndetje për nënkryetarin e Komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, drejtorët që janë prezent në këtë mbledhje, përfaqësuesi i OSBE-së. Mirë se keni ardhur në mbledhjen e parë të rregullt të KPF-së për këtë vit! Uroj që të kemi një vit të mbarë. Pasi që është seanca e parë, më lejoni të uroj një vit të mbarë. Desha të ju njoftoj se, thuaja të gjitha aktet që i kemi miratuar kanë marr ligjshmërinë nga ana e MAPL-së, përveç një ndryshim plotësim të vendimit që do ta diskutojmë në këtë mbledhje. A ka dikush jashtë rendit të ditës ju lutem?

**znj.Liridona Bislimi:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Nënkryetar, jemi tu e diskutu disa here këtë problematikë, e cila ka të bëjë me ndriçimin publik në Komunën e Vitisë. Fatkeqësisht po bëhet njëfar disbalancimi sa i përket këtij ndriçimi publik dhe mendoj që, si këshilltar komunal jemi bë të tepërt tu e diskutu këtë çështje çdoherë dhe tu pas ankesa të njëjta prej qytetarëve sa i përket ndriçimit publik. Unë mendoj që është mirë ndoshta më pas një takim me kompani, edhe me diskutu njëherë e mirë për këtë çështje në lagjen time. E di që në fund të muajit të kaluar janë bë ndriçimet e poqeve elektrike edhe si kemi pas problemet e mëhershme shumë mirë ato poqa që janë vendos. Menjëherë pas javës së parë kanë fillu me qenë më të dobëta, kanë kalu ndoshta 3 javë dhe ndriçimi elektrik nuk bënë fare. Në anën tjetër kemi parë postime të banorëve të fshatit Skifteraj, ku ndriçimi publik elektrik është i vendosur edhe gjatë ditës. Është mirë që kjo çështje njëherë mirë mu rregullu, për shkak se kemi hyrë në vitin e 3-të edhe nuk po di nëse ka ndonjë seancë ose komitet që nuk është diskutu kjo problematikë. Po mendoj që është bërë e tepërt, ndoshta është mirë me diskutu me kompaninë dhe me ja tregu këtë çështje që ata me marrë më seriozisht. Neve si banorë të lagjes “Kadri Zeka” na erdh mirë që është bërë ndriçimi elektrik, ndryshimi atyre, mirëpo me vendos për me qenë funksional për vetëm 3-4 javë, kjo është e papranueshme, është e papranushme edhe kjo tjetra, ku banorët po na dërgojnë foto, video, ku ndriçimi publik në Komunën e Vitisë punon dhe ditën.

**z.Jakup Demiri:** Ne e kemi këtë punën e KPF-së. Liridona ka qenë deri tani, prej tani do të jetë Majlinda, kështu ka qenë marrveshja. Po ju njoftoj tani se, në Kuvend duhet me ndërru anëtarin e KPF-së.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Duhet ta bëni kërkesën me shkrim për në Kuvend dhe ne e votojmë, pasi që këto janë çështje të brendshme në partinë e juaj.

**z.Jakup Demiri:** Tek ndriçimi publik nënkryetar, dua ta thirresh kompaninë e cila e ka mbikëqyrë me ardh

në Kuvend Komunal, me sjellë një raport të flasim, se Beka është këtu i Smirës. Ndryçimi publik në Smirë shumicën e kohës bënë në mëngjes, kjo problematik është shumë kohe të gjatë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Përshendetje të nderuar të pranishëm! Çështjen e ndryçimit e kemi diskutu në çdo mbledhje. Unë si përfaqësues i ekzekutivit kurrnjëhere nuk e kam neglizhu këtë çështje, dhe në mbledhjen e fundit të Kuvendit e kam thirrë edhe Xhelal Musen, i cili është mbikëqyrës i kësaj kontrate. Unë muj me bisedu prapë me Xhelalin, e me kompaninë nuk besoj që muj me thirrë në Kuvend, sepse është kompani private dhe nuk na jep llogari neve, po duhet mi i dhanë mbikëqyrësit, e ai me propozimet e tij nodhshta me i marr edhe çështjet e sanksioneve nga ana e Komunës. Ajo çka mu më ka thanë se, tash ndryçimi i poqeve naj ka shkakto edhe avarinë, sipas tyre po ajo avaria ndoshta mundet me qëndru një javë ose dy, se duhet mu stabilizu edhe unë e kam ngrit këtë shqetësim në takimet që i kemi. Duhet me kërku edhe nga Xhelali me naj dhanë një informatë.

**z.Ramadan Deliu:** Përshendetje për të gjithë! Me Xhelalin fol kot, ai thotë dalim nesër, të hënën, po duhet me i thanë duhet mu u kry kjo punë edhe kaq. Kahë “Morava” që gjashtë muaj e kemi ngritë, hala një dritë nuk është ndreq.

**Kryesuesi, z. Bekim Azizi:** Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, për këtë mbledhje kemi këtë:

## **R e n d d i t e**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e njëmbëdhjetë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të Kuvendit të komunës së Vitisë për Vitin 2024.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e komisionit vlerësues për shqyrtimin e dokumentacioneve për vendosjen e bizneseve në Parkun Industrial në Budrik të Epërme.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e Planit të Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për Vitin 2024.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronat e paluajtshme në pronësi të pronarëve Kadri (Bislim) Emërllahu dhe Agron (Ahmet) Ahmeti.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e Propozim Vendimit për Shfuqizimin e Vendimit për Miratimin e Planit të Integritetit 2023-2026 të Komunës së Vitisë, Vendimi me Nr.01-110/05-163, i datës 01-03-2023.
7. Informatë mbi punën e Kuvendit Komunal dhe komiteteve funksionale për periudhën janar - dhjetor 2023.
8. Informatë mbi punën e Komitetit për Komunitete të Komunës së Vitisë për periudhën janar - dhjetor 2023.
9. Informatë për zbatimin e Planit të KKSB-së për Vitin 2023.

Edhe një pikë e kemi tashti që na ka ardh nga ministria tek plani zhvillimor komunal, që kanë thanë duhet një vendim për miratimin e planit zhvillimor komunal, me e hek nenin 3 të vendimit. Matrialin e merrni për Kuvend, prandaj propozoj që në rend dite të hin edhe ky propozim vendim për ndryshim të vendimit për miratimin e planit zhvillimor komunal. A keni me shtu diçka rreth rendit të ditës? Pasi që nuk ka për diskutim qes në votim për miratim rendin e ditës me këtë pikë. Nga të gjithë të pranishmit u miratu rendi i dites:

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

**1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e njëmbëdhjetë e Komitetit për Politikë dhe Financa**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Me ngritje të dorës: a jeni për miratimin e procesverbalit? Me të gjitha votat miratohet procesverbali.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi:

**2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin 2024**

Si çdo here duhet me e pas këtë propozim vendim që, t'i dimi datat përafërsisht se kur do t'i kemi mbledhjet orientimish. Nuk do me thanë që janë data fikse, munden me ndryshu këto data nëse ka naj diskutim.

**z.Jakup Demiri:** 5 Maji është Dita e Dëshmorëve të Komunës sonë, po është edhe Dita e Dëshmorëve të Kombit në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Unë nuk e kam lexu, po ma ka dhanë një vërejtje dikush. më ka thanë që, ju Vitia e keni pak dallash. Këtu është mirë me e këshyrë qysh është e parapamë në Kushtetutën e Shqipërisë. Këtë po e thamë si informatë. Mos kishte me qenë mirë që ne me këshyrë së paku kur ta mbajmë seancën, në fjalim me e përfshi edhe këtë se është ditë e dëshmorëve.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Jakup, ne jemi të obliguar t'i përmbahemi ligjeve të Kosovës dhe Statutit të Komunës së Vitisë dhe me statut i kemi parapa këto seanca. Ne në programin tonë që duhet me i paraqitë në Kuvend, me i miratu, është në bazë të statutit që këto 3 data. Pra, pasi që nuk ka më për debat: a jeni që kjo pikë të shkoj në Kuvend? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, kjo pikë shkon për në Kuvend.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

**3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e komisionit vlerësues për shqyrtimin e dokumentacioneve për vendosjen e bizneseve në Parkun Industrial në Budrik të Epërme**

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Zakonisht këto grupet e këshilltarëve po takohen ditën kur po mbahet Kuvendi, prandaj një shkon nga partia që është në pushtet dhe një do të jetë nga opozita, për shkak të premjes së shiritit dhe pranimit të parkut të biznesit. Besoj, nuk duhet me u vonu, për shkak duhet të formohet komisioni dhe duhet të del thirja për dhënie në shfrytëzim të të gjithë atyre që janë të interesuar. Ndoshta do të ishte mirë të paraqitet edhe komisioni i ankesave menjëherë, por unë kam mendu që në shkurt në seancën tjetër për shkak të ngarkesës së pikave, por me urgjencë është kjo, se duhet me u përgatit materiali për me fillu thirrjen për bizneset të cilat janë të interesum. Nga ekzekutivi janë propozu këta nga shoqëria civile, Tefiku dhe 2 do ti zgjedh Kuvendi në seancën e radhës.

**z.Jakup Demiri:** Kuvendi Komunal nëpër të gjitha komisionet që i formon duhet të jetë 51% thotë një rregullore anëtarë të Kuvendit, e këtu janë 2 të ekzekutivit një të shoqërisë civile po e formon Kuvendi Komunal.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Ka shumë trupa që i formon Kuvendi dhe asnjë anëtar nuk e ka. Ta marrë një shembull, udhëzimi administrativ e rregullon KKSB-në, por asnjë nuk është anëtar i Kuvendit, por duhet me marr bekimin nga ana e Kuvendit, se vendimet i nxjerr Kuvendi.

**z.Jakup Demiri:** Kemi qenë një trajnim në Gilan, ka qenë një master i Prizirenit që ka thënë kështu, për atë po lidhem që aty e kam dëgju.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Nënkryetar, a ki informatë si shkon rregullorja, çështja e procedurave, a vjen në Kuvend lista mu miratu kujna ju jepet në shfrytëzim

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Unë besoj që po, se ka me shku me këtë Ligjin mbi Dhënien në Shfrytëzim. Nuk jam marrë shumë me të, jam marrë me formimin e trupës si do të jetë dhe trupa duhet të jetë në këtë formë. Këta e kanë lejen për me fillu procedurat për me i shqyrtu ato kërkesa të cilat bëhen dhe konsideroj që këtij komisioni duhet me qenë edhe një komison i ankesave që duhet me dalë edhe ai prej Kuvendit.

**z.Ramadan Deliu:** Kjo në Kuvend nuk vjen më.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Propozimet e tij kujt ja kanë nda vijnë Dan. A ja dhe një seancë në Devajë, a erdh në Kuvend.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pasi që nuk ka më për debat; a jeni që kjo pikë të shkoj në Kuvend. Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim kjo pikë shkon për në Kuvend.

Si pikë e katërt e rendit të ditës:

#### **4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e Planit të Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2024**

**z.Hasan Aliu nënkryetar i Komunës:** Para jush e kemi një plan i cili ka marr bekimin edhe në KKSB në mbledhjen të cilën e kishim në dhjetor, dhe e kam parë të udhës që duhet me ju shtru edhe procedurave të Kuvendit, për shkak se është trup, e cila është formu në Kuvend. Nuk po hi ta lexoj, krejt këtu kanë punu individ të cilët vijnë nga institucionet e ndryshme, edhe nga policia, edhe nga zyrat e ekzekutivit, në veçanti koordinatori, Zyra për Barazi Gjinore, Strategjia Kundër Dhunës. D.m.th ka qenë një mekanizëm që janë mbledh informacione dhe të cilët i kanë futë në planin e punës, i cili do të realizohet në vitin 2024. Për pyetje shtesë jemi në dispozicionin e juaj.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat për këtë temë të rendit të ditës.

**z.Ramadan Deliu:** Pse nuk po paguhen anëtarët e KKSB-së, kush është përgjegjës për këtë?

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Përgjegjës janë Ministria e Financave, të cilët nuk po e bëjnë pagesën, sepse Ligji i ri i Pagave i ka ndalu të gjitha pagesat e anëtarëve dhe këtë problem e kemi të gjitha komunat. Unë për çdo mbledhje i kam dërgu emrat për pagesa po nuk është bë. Në Ministri të Punëve të Brendshme më kanë thanë që e kanë evidentu si problem e mos po e nxjerrin një udhëzim administrativ për me e rregullu këtë çështje. Jemi në kontakt me komuna tjera, ndoshta Komuna e Pejës, Kuvendi mos po e nxjerr një vendim me i pagu prej shërbimeve dhe mallrave. Nëse bajnë ata edhe ne do ta bëjmë një zgjidhje.

**znj.Liridona Bislimi:** Nje gjë që më ka ra në sy tek ky plan, në fund të aktiviteteve, në disa prej tyre janë me transparencë buxhetore. P.sh.: kemi te parandalimi i dhunës në familje, buxhetimi komunal 150 euro. Po kemi rast që nuk ka të shfaqura buxheti hiq. Po më intereson me ditë pse kjo.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Mekanizmat të cilët kanë buru dhe i kryen punën nga Zyra e Krytarit. P.sh.: mekanizmi kundër dhunës në familje e parasheh që është afër, e këta policia nuk e kanë dhanë atë informacion dhe nuk na kushton aktivitetit i tyre.

**znj.Liridona Bislimi:** Nënkryetar, unë kisha kërku nga ju nëse ekziston mundësia që unë me qenë pjesë e kësaj ekipe si kryesuese e grupit të grave, për shkak se, që e kemi përmend me herët. Në komunat tjera kryesuesja e grave e ka bashkëpunimin me të madh me institucione komunale, e ndoshta ka qenë mirë me qenë pjesë edhe unë e këtij grupi.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Nuk me prish punë, ndoshta vetëm me kishe ndihmu në këtë drejtim, po unë besoj që grupa është bukur herët e formuar. Tash nuk po muj me të garantu që muj me të fut ty në atë grup, sepse ndoshta duhet me hek një, e kështu që do ta shqyrtoj mundësinë. Në rast që nuk na prishë punë numri pse mos me qenë.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pasi që nuk ka për diskutim: a jeni të shkon në Kuvend kjo pikë e rendit të ditës? Me votat e të gjithëve shkon në Kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

**5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronat e paluajtshme në pronësi të pronarëve Kadri (Bislim) Emërllahu dhe Agron (Ahmet) Ahmeti**

**znj.Hidajete Aliu, shefe në Drejtorinë e Kadastrit, Pronës:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit. Kemi të bëjmë me këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronat e paluajtshme në pronësi të pronarëve Kadri (Bislim) Emërllahu dhe Agron (Ahmet) Ahmeti. Propozimin e kemi marrë me kohë, për pyetjet shitesë jemi në dispozicionin e juaj.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapim debat për këtë pikë. Unë e di atë vend, gjendja reale është kjo që e prezenton tani, po ne duhet me e rregullu edhe me dokumente. Pasi që nuk ka për diskutim, qes në votim që të shkon në Kuvend. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

**6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e Vendimit për miratimin e Planit të Integritetit 2023-2026 të Komunës së Vitisë, Vendimi me Nr.01-110/05-163, i datës 01-03-2023**

**Fatlum Demiri, zyrtar i lartë i Kuvendit Komunal:** Përshendetje të nderuar të pranishëm! Unë me sa kam fol me Ibadetin, zyrtare përgjegjëse, në vitin e kaluar e kemi miratu Planin e Integritetit për të cilin e kemi marr konfirmimin e ligjshmërisë, e është në fuqi, mirëpo Agjencia Kosovare Kundërkorrupsionit i ka ndryshu disa ligje edhe i ka obligu komunat me i ndryshu edhe planet e integritetit. Deri më tani Planin për Integritet e ka miratu Kuvendi në bazë të informatave të Ibadetit, e cila ka kontakt me Agjensinë Kosovare Kundërkorrupsionit. Ata i kanë thanë që, tani nuk e ka obligim Kuvendi po kryetari i Komunës duhet me e miratu atë plan. Ibadeti e ka për një plan e kanë dërgu në Agjensinë Kosovare Kundërkorrupsionit. Tani unë ju kam propozu, pasi që është bënë një plan i ri, na e kemi një plan të vitit të kaluar i cili është në fuqi, duhet me ndërmarr veprime që me e shfuqizu, sepse nuk mundem me qenë dy plane në të njëjtën kohë në fuqi. Nga kjo edhe ka ardh kjo pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Kërkoj që të konsultohesh me Zyrën Ligjore të MAPL-së dhe hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Jakup Demiri:** Nuk po e kuptoj pse me caktu me 26, kur datat janë deri në fund të muajit.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Kuvendit nuk i ka ardhë asnjë plan. Me ardhë me shkresë, ne tani jemi tu e bënë pa asnjë shkresë, vetëm me një komunikim në mes Ibadetit me antikorrupsionin, që ndoshta nesër thotë, jo nuk ka pas nevojë kjo tani, nesër ne ku mbesim.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Kryesues, edhe unë e kam pas pakjart sot në mëngjes, se kam dëshirë që me u përgatit për KPF dhe Kuvend. Në shtjellim të materialit e kam thirrë Fatlumit për këtë pikë, i kam thanë, nëse ne kemi një plan të cilin ka ja dhanë bekimin Kuvendi dhe atë që ja jep miratimin Kuvendi vetëm Kuvendi mundet me ja marrë. Kjo e ka kuptimin e vetë të plotë, tani kemi një plan të cilin e ka nënshkru kryetari dhe kemi një plan të cilin e ka miratu Kuvendi, prandaj këtë që e ka miratu Kuvendi, Kuvendi duhet me ja marrë dhe me shku atje tjetra në fuqi.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Në rregull, mirëpo si procedurë në Kuvend çka vjen, duhet me pas një shkresë prej ministrisë, që kjo është ajo.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Edhe plani i integritetit, kushdo në të thotë, vetëm akteret, unë që kam qenë në rrjedh, se deri vonë ka qenë shumë i pakuptimt. Me integritet kupton krejt diçka tjetër, po kur të hish në brendi të planit të integritetit, ti krejt e ke rrezikshmërinë ku paraqitetet në komunë, nuk ka të bëjë titulli me brendi askund, po ashtu e kanë titullu.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Unë kisha thanë këtë pikë e kalojmë, e qojmë për Kuvend. Kisha kërku prej Fatlumit në të procedohet me Zyrën Ligjore të MAPL-së, nëse e konstaton deri në Kuvend që nuk ka nevojë të shfuqizohet ose diçka në bazë të konsultimeve me Zyrën Ligjore të MAPL-së, atëhere ne e terhekim prej kësaj.

Pra, pasi që nuk ka për diskutim: a jeni që kjo pikë të shkoj në Kuvend? Me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim kjo pikë shkon në Kuvend.

Si pikë e shtat e rendit të ditës:

#### **7. Informatë mbi punën e Kuvendit Komunal dhe komiteteve funksionale për periudhën janar - dhjetor 2023**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Këtu i kemi paraqitë sa mbledhje i kemi mbajtë, sa vendime, rregullore të gjitha i keni këtu, komitetet joobligative e dini që nuk janë tu funksionu për shkak që nuk ka mundësi të bëhet pagesë dhe për shkak të pagesave deri sa të bëhet një zgjidhje dhe na mbesin kështu. Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pra, pasi që nuk ka për diskutim: a jeni që kjo pikë të shkoj në Kuvend? Me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, kjo pikë shkon në Kuvend.

Si pikë e tetë e rendit të ditës:

#### **8. Informatë mbi punën e Komitetit për Komunitete të Komunës së Vitisë për periudhën janar - dhjetor 2023**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Për këtë pikë të rendit të ditës është Reshati që na jepë informatë. Nëse kemi ndonjë pyetje, përndryshe ne nuk kemi diçka të veçant, ky është një komitet obligativ që mban takime. E di që duhet me u plotsu se një anëtar ka vdekë: a jeni që kjo pikë të shkoj në Kuvend? Me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, kjo pikë shkon në kuvend.

Si pikë e nëntë e rendit të ditës:

#### **9. Informatë për zbatimin e planit të KKSB-së për vitin 2023**

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Unë nuk po ndalem me i lexu, e keni pas materialin, KKSB vazhdon me punën e vetë dhe në vitin 2023 ka mbaru 6 mbledhje që i ka obligative. Zakonisht ne planet tona i paraqesim dhe i mbajmë 7, megjithatë nuk do të thotë që të mbahen 7, varësisht prej situatës. Ato mund të mbahen edhe më tepër, por 6 janë obligative të cilat me udhëzimin administrativ dhe rregulloren të cilën e kemi ato duhet të paguhen. E thatë edhe më herët që, këta nuk janë pagu për vitin 2023. Do ta shikojmë mundësinë. Kjo ishte ajo puna, vazhdimisht është një trup që ka ngritë shumë çështje që janë me rëndësi që kanë pas dhe mirëkuptimin edhe te ekzekutiva që me u kry shumica prej tyre të cilët ka pas edhe aspekt buxhetor, kështu që do ta vazhdojmë edhe me vitin 2024 me atë plan që e kemi.

**Kryesuesi, z. Bekim Azizi:** Hapi debat përë këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për debat: a jeni që kjo pikë të shkoj në Kuvend? Me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, kjo pikë shkon në Kuvend.

Si pikë e dhjetë e rendit të ditës:

#### **10. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e Propozim vendimit për ndryshim të Vendimit për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2023-2031 të Komunës së Vitisë, Vendimi me Nr.01-110/05-49935, i dates 27.12.2023**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** D.m.th, kjo çka e paraqita me herët që në vendim me hekë nenin 3 te plani zhvillimor. Hapi debat përë këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për debat: a jeni që kjo pikë të shkoj në Kuvend? Me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, kjo pikë shkon në Kuvend. Ju falënderoj për kontributin e dhënë në këtë mbledhje të KPPF-së.

Me qaq shpall të mbyllur këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:30

**Procesmbajtësi:**  
**Fatlum Demiri**

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**  
**Bekim Azizi**



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA - MUNICIPAL VITINA



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prilijeno Më/Dana 31-01-2024 v.l.pz.

nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vlerësimi
02	402	01	M1

## Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-dhjetor 2023

Viti 30.01.2024







REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA - MUNICIPAL VITINA



**DREJTORIA E FINANCAVE**

Data/Datum/Date	30.01.2024
Nr/Br.	
Për/Za/To	Kuvendin e Komunës, Komitetin për Politikë dhe Financa
Përmes/Preko/Through	Sokol Haliti, Kryetar i Komunës 
Nga/Od/From	Milohate Ajeti U.D. Drejtorise për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim 
Lënda/Predmet/Subject	Pasqyrat Financiare për periudhën janar-dhjetor 2023

Bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin mbi Financat Lokale si dhe Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë paraqesim pasqyrat financiare të organizatës sonë buxhetore (657) për periudhën janar-dhjetor 2023 përfshirë të hyrat vetanake të realizuara si dhe shpenzimet buxhetore për të gjitha kategoritë ekonomike.

**Të hyrat**

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2023 janë inkasuar gjithësej të hyra vetanake në vlerë prej 1.434.091,43€, shkalla e inkasimit, duke u bazuar në planifikimin vjetor është 136,21%, ndërsa krahasuar me të hyrat për periudhën janar – dhjetor të vitit 2022 të hyrat e vitit 2023 janë me të larta për 250.723,51€

**Shpenzimet Buxhetore**

Buxheti i Alokuar për periudhën janar – dhjetor të vitit 2023 nga fondet burimore: Granti qeveritar, të hyrat vetanake, dhe donacionet janë: 17.800.766,10€, ndërsa shpenzimet janë: 17.059.275,82€, shkalla e ekzekutimit të buxhetit për periudhën janar- dhjetor 2023 është 95,83% në krahasim me Alokimet për të gjitha programet dhe kategoritë ekonomike.

Në vazhdim të këtyre pasqyrave në mënyrë tabelare do të paraqesim shpenzimet buxhetore, duke i specifikuar sipas burimeve të financimit, programeve dhe kategorive Ekonomike.

**Buxheti i Aprovuar,Alokuar dhe i shpenzuar per te Gjitha programet buxhetore - janar-dhjetor 2023**

Aprovim						
	<b>Kateg.&amp;Ekonomik</b>	Aprovime 10	Aprovime 21	Aprovimet 22	Aprovimet Donacionet	Totali i Aprovimeve
1	Pagat &Shtesat	9,096,122.99	0.00	0.00	25,281.90	9,121,404.89
2	Mall.&Sherbime	2,243,765.00	249,000.00	114,012.77	22,088.74	2,628,866.51
3	Komunali	325,000.00	0.00	0.00	0.00	325,000.00
4	Subvencione	376,386.00	193,614.00	144,487.73	193,415.25	907,902.98
5	Kapitale	3,389,000.00	670,205.00	93,020.98	665,365.74	4,817,591.72
		15,430,273.99	1,112,819.00	351,521.48	906,151.63	17,800,766.10

Alokimet						
	<b>Kateg.&amp;Ekonomik</b>	Alokimet 10	Alokimet 21	Alokimet22	Alokimet Donacionet	Totali i Alokimeve
1	Pagat &Shtesat	9,096,122.99	0.00	0.00	25,281.90	9,121,404.89
2	Mall.&Sherbime	2,243,765.00	249,000.00	114,012.77	22,088.74	2,628,866.51
3	Komunali	325,000.00	0.00	0.00	0.00	325,000.00
4	Subvencione	376,386.00	193,614.00	144,487.73	193,415.25	907,902.98
5	Kapitale	3,389,000.00	670,205.00	93,020.98	665,365.74	4,817,591.72
		15,430,273.99	1,112,819.00	351,521.48	906,151.63	17,800,766.10

Te paalokuara						
	<b>Kateg.&amp;Ekonomik</b>	Alokimet 10	Alokimet 21	Alokimet22	Alokimet Donacionet	Totali i Alokimeve
1	Pagat &Shtesat	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2	Mall.&Sherbime	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
3	Komunali	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
4	Subvencione	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
5	Kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00

Shpenzimet							
	<b>Kateg.&amp;Ekonomik</b>	Shpenzimet 10	Shpenzimet 21	Shpenzimet 22	Shpenzimet Donacionet	Totali i Shpenzimeve	% shpenzimit
1	Pagat &Shtesat	9,096,106.44	0.00	0.00	0.00	9,096,106.44	99.72%
2	Mall.&Sherbime	2,213,870.36	242,085.26	113,086.93	0.00	2,569,042.55	97.72%
3	Komunali	317,042.90	0.00	0.00	0.00	317,042.90	97.55%
4	Subvencione	367,671.00	190,646.35	137,463.03	74,181.20	769,961.58	84.81%
5	Kapitale	3,262,653.35	557,897.93	90,163.02	396,408.05	4,307,122.35	89.40%
		15,257,344.05	990,629.54	340,712.98	470,589.25	17,059,275.82	95.83%

Diferenca Alokim-Shpenzim						
	<b>Kateg.&amp;Ekonomik</b>	Shpenzimet 10	Shpenzimet 21	Shpenzimet 22	Shpenzimet Donacionet	Totali i Shpenzimeve
1	Pagat &Shtesat	16.55	0.00	0.00	25,281.90	25,298.45
2	Mall.&Sherbime	29,894.64	6,914.74	925.84	22,088.74	59,823.96
3	Komunali	7,957.10	0.00	0.00	0.00	7,957.10
4	Subvencione	8,715.00	2,967.65	7,024.70	119,234.05	137,941.40
5	Kapitale	126,346.65	112,307.07	2,857.96	268,957.69	510,469.37
		172,929.94	122,189.46	10,808.50	435,562.38	741,490.28

Diferenca Aprovim-Shpenzim						
	<b>Kateg.&amp;Ekonomik</b>	Shpenzimet 10	Shpenzimet 21	Shpenzimet 22	Shpenzimet Donacionet	Totali i Shpenzimeve
1	Pagat &Shtesat	16.55	0.00	0.00	25,281.90	25,298.45
2	Mall.&Sherbime	29,894.64	6,914.74	925.84	22,088.74	59,823.96
3	Komunali	7,957.10	0.00	0.00	0.00	7,957.10
4	Subvencione	8,715.00	2,967.65	7,024.70	119,234.05	137,941.40
5	Kapitale	126,346.65	112,307.07	2,857.96	268,957.69	510,469.37
		172,929.94	122,189.46	10,808.50	435,562.38	741,490.28

## Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit për të gjitha njësit buxhetore

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	9,121,404.89	9,121,404.89	9,096,106.44	25,298.45	25,298.45	99.72%
2	Mallra dhe sherbime	2,628,866.51	2,628,866.51	2,569,042.55	59,823.96	59,823.96	97.72%
3	Subvencione	907,902.98	907,902.98	769,961.58	137,941.40	137,941.40	84.81%
4	Komunal	325,000.00	325,000.00	317,042.90	7,957.10	7,957.10	97.55%
5	Shpenzime kapitale	4,817,591.72	4,817,591.72	4,307,122.35	510,469.37	510,469.37	89.40%
	<b>Gjithsejt</b>	<b>17,800,766.10 €</b>	<b>17,800,766.10 €</b>	<b>17,059,275.82 €</b>	<b>741,490.28 €</b>	<b>741,490.28 €</b>	<b>95.83%</b>

## Shpenzimet për të gjitha njësit buxhetore

Kodi Përshkrimi	Shuma
11110 Paga neto	7,422,407.51
11500 Tatimi në paga	489,039.16
11600 Kontributi i punëtorit	416,788.32
11700 Kontributi i punëdhënsit	416,788.32
11115 Sindikata	18,612.55
11125 OIK	2,570.14
11126 OMK	1,920.00
11900 Paga per vendime gjyqesore	327,980.44
<b>Totali i pagave</b>	<b>9,096,106.44</b>
13130 Shpenzimet e udhëtimit mbrenda vendit	13,643.43
13132 Akomodimi i udhëtimeve zyrtar mbrenda vendit	2,512.00
13134 Shp. te transportit per udhetime brenda vendit	2,942.50
13140 Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashte vendit	16,252.05
13141 Shpenzimet e vogla -Shpenzime jashte vendit	1,006.80
13142 Akomodimi - udhëtimet zyrtare jashte vendit	4,391.02
13143 Shpenzime tjera - udhëtimeve zyrtare jashte vendit	350.00
13144 Shp.te transportit per udhetime zyrtare jashte ven	3,624.64
13210 Shpenzimet e rrymës	181,926.22
13220 Shpenzimet e ujit	17,180.82
13230 Shpenzimet e mbeturinave	38,224.42
13250 Shpenzimet e telefonis fikse	9,913.38
13310 Shpenzimet per internet	4,234.67
13320 Shpenzimet e telefonis mobile	15,472.35
13330 Shpenzimet postare	7,759.64
13340 Shpenzimet per perdorimit e kabllit optik	400.00
13410 Sherbimet e aresimit dhe trajnimit	6,320.00
13420 Sherbimet e perfaqesimit avokature	12,352.66
13430 Sherbime te ndryshme shendetesore	524,474.40
13440 Sherbime te ndryshme intelektuale dhe keshill.	34,938.75

13450	Sherbime shtypje - jo marketing	46,584.03
13460	Sherbime Kontraktuese tjera	201,769.39
13470	Sherbime teknike	16,979.00
13480	Shpenzimet per anetaresim	8,548.05
13503	Furnizim me kompjuter	71,120.20
13508	Paisje trafiku	9,085.10
13509	Paisje tjera	353,547.94
13610	Furnizime për zyre	67,957.08
13611	Furnizime me dokumenta blanko	5,371.80
13620	Furnizimi me ushqim dhe pije(jo dreka zyrtare)	34,525.44
13630	Furnizime mjekesore	94,210.49
13640	Furnizime pastrimi	16,158.30
13650	Furnizim me veshembathje	1,575.00
13720	Nafte per ngrohje qendrore	6,723.69
13760	Furnizim me lende djegese (Dru)	216,555.00
13770	Derivate per gjenerator	2,901.85
13780	Derivate veturave	58,292.15
13950	Regjistrimi i automjeteve	4,665.00
13951	Sigurimi i automjeteve	9,389.91
14010	Mirembatja dhe riparim i automjeteve	48,135.88
14020	Mirembatja e ndertesave	256,064.30
14023	Mirembatja e shkollave	1,011.31
14032	Mirembatja e autorrugeve lokale	191,866.03
14040	Mirembatja e teknologjis informative	7,194.90
14050	Mirembatja e mobiljeve dhe paisjeve	46,083.20
14060	Mirembatja rutinore	18,035.00
14220	Botimet e publikimeve	7,350.00
14230	Shpenzimet per informim publik	27,471.52
14310	Dreka zyrtare	46,825.33
13260	Pagesa - Vendime gjyqesore	69,798.06
14410	Shpenzime - vendimet e gjykatave	29,145.39
14415	Pagesat per tarifa - vendimet gjyqesore /permbat	13,225.36
	<b>Totali për shërbimeve mallra dhe komunal</b>	<b>2,886,085.45</b>
200	Subvencionet dhe transfere	657,388.93
22300	pagesa - vendime gjyqesore	112,572.65
	<b>Totali i subvencioneve</b>	<b>769,961.58</b>
300	Investime kapitale	3,888,416.08
34000	Pagesa - vendime gjyqesore	418,706.27
	<b>Totali i investimeve kapitale</b>	<b>4,307,122.35</b>
	<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>17,059,275.82 €</b>

Zyra e Kryetarit  
Kodi 16033

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	314,253.41	314,253.41	314,253.41	0.00	0.00	100.00%
2	Mallra dhe shërbime	135,003.30	135,003.30	126,396.43	8,606.87	8,606.87	93.62%
3	Subvencione	194,121.00	194,121.00	188,059.73	6,061.27	6,061.27	96.88%
4	Komunal	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
5	Shpenzime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
	<b>Gjithsej</b>	<b>643,377.71 €</b>	<b>643,377.71 €</b>	<b>628,709.57 €</b>	<b>14,668.14 €</b>	<b>14,668.14 €</b>	<b>97.72%</b>

Shpenzimet e Zyres Kryetarit 16033

Kodi	Përshkrimi	Shuma
11110	Paga neto	265,598.85
11500	Tatimi në paga	18,675.65
11600	Kontributi i punëtorit	14,965.06
11700	Kontributi i punëdhënësit	14,965.06
11115	sindikata	48.79
	<b>Totali i pagave</b>	<b>314,253.41</b>
13140	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	4,885.80
13141	Shpenzimet e vogla - Shpenzime jashtë vendit	316.80
13143	Shpenzime tjera - udhëtimeve zyrtare jashtë vendit	350.00
13144	Shp.te transportit per udhetime zyrtare jashte vendit	2,154.04
13440	Sherbimet e ndryshme intelektuale dhe keshilledhënes	1,365.09
13450	shërbime shtypje - jo marketing	12,914.24
13460	Sherbime kontraktuese tjera	70,764.26
13480	Shpenzimet per anetaresim	2,048.05
13503	Komjuter	1,268.00
13620	Furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	1,077.10
13780	Karburant per vetura	106.51
13950	Regjistrimi i automjeteve	145.00
13951	Sigurimi i automjeteve	333.79
14020	Mirembajtja e nderesave	39.00
14040	Mirembajtja e teknologjis informative	533.00
14220	Botimet e publikimeve	6,050.00
14230	Shpenzimet per informim publik	9,835.50
14310	Dreka zyrtare	12,098.10
14415	Pagesat per tarifa - vendimet gjyqesore /pembarmimore	112.15
	<b>Totali për shërbime dhe mallra</b>	<b>126,396.43</b>
200	Subvencione dhe transfere	167,896.00
22300	Pagesa - vendime gjyqesore	20,163.73
	<b>Totali i subvencioneve</b>	<b>188,059.73</b>
300	Investime kapitale	0.00
	<b>Totali i investimeve kapitale</b>	<b>0.00</b>
	<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>628,709.57 €</b>

Administrata dhe personeli

Kodi 16333

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	199,067.19	199,067.19	199,067.19	0.00	0.00	100.00%
2	Mallra dhe shërbime	95,000.00	95,000.00	94,121.28	878.72	878.72	99.08%
3	Subvencione	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
4	Komunali	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
5	Shpenzime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
	<b>Gjithsej</b>	<b>294,067.19</b>	<b>294,067.19</b>	<b>293,188.47</b>	<b>878.72</b>	<b>878.72</b>	<b>99.70%</b>

Shpenzimet - Administrata dhe Personeli - 16333

Kodi	Përshkrimi	Shuma
11110	Paga neto	170,678.70
11500	Tatimi në paga	9,392.21
11600	Kontributi i punëtorit	9,479.48
11700	Kontributi i punëdhënsit	9,479.48
11115	Sindikata	37.32
	<b>Totali i pagave</b>	<b>199,067.19</b>
13132	Akomodimi i udhetimeve zyrtar mbrenda vendit	2,512.00
13430	Shërbime të ndryshme shëndetësore	271.66
13450	Shërbime shtypje -jo marketing	271.45
13460	Shërbime kontraktuese tjera	4,835.43
13503	Kompiuter	7,276.00
13509	Pajisje tjera	1,340.00
13610	Furnizimi për zyre	3,662.75
13611	Furnizimi me dokumenta bilanko	2,490.00
13620	Furnizimi me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	820.60
13720	Nafte për ngrohje qendrore	4,152.49
13770	Derivate për gjenerator	828.70
13780	Karburant për vetura	17,920.06
13950	Regjistrimi i automjeteve	1,060.00
13951	Sigurimi i automjeteve	2,651.78
14010	Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve	14,611.00
14020	Mirembajtja e ndërtesave	6,998.70
14040	Mirembajtja e teknologjis informative	210.00
14050	Mirembajtja e mjeteve dhe pajisjeve	15,567.90
14230	Shpenzimet për informim publik	2,426.76
14310	Drekat zyrtare	4,214.00
	<b>Totali për shërbime dhe mallra</b>	<b>94,121.28</b>
200	subvencione dhe transfere	0.00
	<b>Totali i subvencioneve</b>	<b>0.00</b>
300	Investime kapitale	0.00
	<b>Totali i investimeve kapitale</b>	<b>0.00</b>
	<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>293,188.47 €</b>

Inspeksioni  
Kodi 16665

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	64,473.44	64,473.44	64,473.44	0.00	0.00	100.00%
2	Mallra dhe shërbime	104,000.00	104,000.00	103,845.08	154.92	154.92	99.85%
3	Subvencione	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
4	Komunal	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
5	Shpenzime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
	<b>Gjithesëjt</b>	<b>168,473.44 €</b>	<b>168,473.44 €</b>	<b>168,318.52 €</b>	<b>154.92 €</b>	<b>154.92 €</b>	<b>99.91%</b>

Shpenzimet - Inspeksioni - 16665

Kodi	Përshkrimi	Shuma
11110	Paga neto	54,554.41
11500	Tatimi në paga	3,787.60
11600	Kontributi i punëtorit	3,054.58
11700	Kontributi i punëdhënsit	3,054.58
11115	Sindikata	22.27
	<b>Totali i pagave</b>	<b>64,473.44</b>
13140	Shpenzimet e udhëtimet zyrtar jashtë vendit	990.00
13440	Shërbime të ndryshme intelektuale dhe keshilldhënëse	11,071.50
13460	Shërbime kontraktuese tjera	7,665.00
13503	Kompjuter	1,127.60
13508	Paisje trafiku	9,085.10
13509	Pajisje tjera	57,000.00
13610	Furnizimi për zyre	432.00
13611	Furnizimi me dokumenta blanko	1,422.00
13620	Furnizimi me ushqim dhe pije - jo dreka zyrtare	342.70
14040	Mirembajtja e teknologjis informative	93.00
14410	Shpenzime-vendimet e gjykatave	1,502.97
14415	Pagesa për tarifa -vendimet gjyqësore/permbartimore	13,113.21
	<b>Totali për shërbimeve dhe mallra</b>	<b>103,845.08</b>
200	Subvencionet dhe transfere	0.00
	<b>Totali i subvencioneve</b>	<b>0.00</b>
300	Investime kapitale	0.00
	<b>Totali i investimeve kapitale</b>	<b>0.00</b>
	<b>Gjithesj shpenzimet</b>	<b>168,318.52 €</b>

Zyra e Kuvendit Komunal  
Kodi 16933

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	195,916.68	195,916.68	195,916.68	0.00	0.00	100.00%
2	Mallra dhe shërbime	17,000.00	17,000.00	17,000.00	0.00	0.00	100.00%
3	Subvencione	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
4	Komunali	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
5	Shpenzime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
	<b>Gjithsej</b>	<b>212,916.68</b>	<b>212,916.68</b>	<b>212,916.68</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>100.00%</b>

Shpenzimet e zyrës së Kuvendit Komunal

Kodi	Përshkrimi	Shuma
11110	Paga neto	165,615.30
11500	Tatimi në paga	12,456.92
11600	Kontributi i punëtorit	8,922.23
11700	Kontributi i punëdhënsit	8,922.23
	<b>Totali i pagave</b>	<b>195,916.68</b>
13142	Akomodimi-udhëtimet zyrtare jashte vendit	3,250.00
13144	shp.te transportit per udhetime zyrtare jashte vendit	1,470.60
13430	Shërbime të ndryshme shëndetësore	4,424.20
13610	Furnizime për zyrë	420.00
14040	Mirembajtja e teknologjis informative	27.00
14230	Shpenzimet për informim publik	7,056.50
14310	Dreka Zyrtare	351.70
	<b>Totali për shërbimeve dhe mallra</b>	<b>17,000.00</b>
200	Subvencione dhe transfere	
	<b>Totali i subvencioneve</b>	<b>0.00</b>
300	Investime Kapitale	0.00
	<b>Totali i investimeve kapitale</b>	<b>0.00</b>
	<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>212,916.68 €</b>



Buxhet e financa  
Kodi 17533

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	196,095.28	196,095.28	171,368.38	24,726.90	24,726.90	87.39%
2	Mallra dhe shërbime	121,662.04	121,662.04	97,710.36	23,951.68	23,951.68	80.31%
3	Subvencione	111,559.74	111,559.74	0.00	111,559.74	111,559.74	0.00%
4	Komunal	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
5	Shpenzime kapitale	4,292,781.03	4,292,781.03	3,818,618.59	474,162.44	474,162.44	88.95%
	<b>Gjithsej</b>	<b>4,722,098.09 €</b>	<b>4,722,098.09 €</b>	<b>4,087,697.33 €</b>	<b>634,400.76 €</b>	<b>634,400.76 €</b>	<b>86.57%</b>

Shpenzimet - Buxhet e Financa 17533

Kodi	Pershkrimi	Shuma
11110	Paga neto	145,713.07
11500	Tatimi në paga	9,310.65
11600	Kontributi i punëtorit	8,160.06
11700	Kontributi i punëdhënsit	8,160.06
11115	Sindikata	24.54
	<b>Totali i pagave</b>	<b>171,368.38</b>
13140	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashte vendit	3,847.46
13141	Shpenzime te vogla (shpenzime jashte vendit)	370.00
13330	Shpenzimet postare	7,722.64
13410	Shërbime e arsimi dhe trajnim	5,000.00
13420	Shërbimet e perfaqesimit avokature	12,352.66
13430	Shërbime te ndryshme shëndetësore	3,106.84
13440	Shërbime te ndryshme intelektuale dhe keshill.	21,433.41
13460	Shërbime kontraktuese tjera	18,466.87
13480	Shpenzimet per anetaresim	6,500.00
13503	Komputer	6,763.40
13509	Pajisje tjera	41.00
13610	Furnizime per zyre	4,567.52
13611	Furnizimi me dokumenta blanko	240.00
13620	Furnizimi me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	681.30
13950	Regjistrimi i automjeteve	95.00
13951	Sigurimi i automjeteve	497.28
14010	Mirembatja dhe riparimi i automjeteve	390.00
14040	Mirembatja e teknologjis informativ	696.40
14220	Botimet e publikime	300.00
14230	Shpenzimet per informim publik	2,193.15
14310	Dreka zyrtare	2,445.43
	<b>Totali për shërbime dhe mallra</b>	<b>97,710.36</b>
200	subvencione dhe transfere	0.00
	<b>Totali i subvencioneve</b>	<b>0.00</b>
300	Investime Kapitale	3,553,896.97
34000	Pagesa - vendime gjyqësore	264,721.62
	<b>Totali i investimeve kapitale</b>	<b>3,818,618.59</b>
	<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>4,087,697.33 €</b>

Sherbime Publike, mbrotje civile, emergjenca  
Kodi 180

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	289,879.84	289,879.84	289,879.84	0.00	0.00	100.00%
2	Mallra dhe sherbime	796,107.75	796,107.75	791,988.45	4,119.30	4,119.30	99.48%
3	Subvencione	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
4	Komunali	182,000.00	182,000.00	177,694.06	4,305.94	4,305.94	97.63%
5	Shpenzime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
	Gjithsej	1,267,987.59 €	1,267,987.59 €	1,259,562.35 €	8,425.24 €	8,425.24 €	99.34%

Shpenzimet - Sherbime Publike, mbrotje civile, emergjenca 180

Kodi	Përshkrimi	Shuma
11110	Paga neto	245,049.77
11500	Tatimi në paga	17,210.95
11600	Kontributi i punëtorit	13,803.73
11700	Kontributi i punëdhënsit	13,803.73
11115	Sindikata	11.66
	<b>Totali i pagave</b>	<b>289,879.84</b>
13140	Shpenzimet e udhëqimit zyrtar jashtë vendit	44.46
13141	Shpenzime të vogla - para xhepi	320.00
13142	Akomodimi - udhëtimet zyrtare jashtë vendit	1,141.02
13210	Shpenzimet e rymës	118,114.02
13220	Shpenzimet e ujit	3,103.70
13230	Shpenzimet e mbeturinave	11,715.18
13250	Shpenzimet e telefonis fikse	7,142.69
13320	Shpenzimet e telefonis mobile	15,472.35
13430	Sherbime të ndryshme shëndetësore	6,815.34
13450	Sherbime shtypje - jo marketing	4,430.02
13460	Sherbime kontraktuese tjera	23,356.22
13470	Sherbime teknike	165.20
13503	Komputer	1,063.40
13509	Pajisje tjera	234,426.08
13610	Furnizime për zyre	1,898.97
13620	Furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	337.31
13770	Derivate për gjenerator	347.16
13780	Karburant për vetura	12,717.08
13950	Regjistrimi i automjeteve	1,850.00
13951	Sigurimi i automjeteve	2,816.84
14010	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	12,594.00
14020	Mirëmbajtja e ndërtesave	243,796.10
14032	Mirëmbajtja e autorrugeve lokale	181,740.48
14040	Mirëmbajtja e teknologjis informativë	225.00
14050	Mirëmbajtja e mobiljeve dhe paisjeve	690.70
14060	Mirëmbajtja rutinore	18,035.00
14220	Blimet e publikimeve	270.00
14310	Drekat zyrtare	1,270.30
13260	Pagosa - vendime gjyqësore	37,618.47
14410	Shpenzime - vendimet e gjykatave	26,165.42
	<b>Totali për shërbime mallra dhe komunali</b>	<b>969,682.51</b>
200	Subvencione dhe transfere	0.00
	<b>Totali i subvencioneve</b>	<b>0.00</b>
300	Investime kapitale	0.00
	<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>1,259,562.35 €</b>

## Zyra e komuniteteve

Kodi 19865

## Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	19,295.22	19,295.22	19,295.22	0.00	0.00	100.00%
2	Mallra dhe shërbime	3,000.00	3,000.00	2,956.14	43.86	43.86	98.54%
3	Subvencione	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
4	Komunali	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
5	Shpenzime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
	<b>Gjithsej</b>	<b>22,295.22</b>	<b>22,295.22</b>	<b>22,251.36</b>	<b>43.86</b>	<b>43.86</b>	<b>99.80%</b>

## Shpenzimet - Zyra e Komuniteteve - 19865

Kodi	Përshkrimi	Shuma
11110	Paga neto	16,399.00
11500	Tatimi në paga	1,039.80
11600	Kontributi i punëtorit	918.88
11700	Kontributi i punëdhënësit	918.88
11115	Sindikata	18.66
	<b>Totali i pagave</b>	<b>19,295.22</b>
13430	Sherbime të ndryshme shëndetësore	298.34
13460	Sherbime kontraktuese tjera	2,507.80
14220	Botimet e publikimit	150.00
	<b>Totali për shërbime dhe mallra</b>	<b>2,956.14</b>
200	Subvencione dhe transfera	0.00
	<b>Totali i subvencioneve</b>	<b>0.00</b>
300	Investimet Kapitale	0.00
	<b>Totali i investimeve kapitale</b>	<b>0.00</b>
	<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>22,251.36 €</b>

M

Bujqësi pylltari dhe zhvillim rural  
Kodi 47033

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	81,447.92	81,447.92	80,892.92	555.00	555.00	99.32%
2	Mallra dhe shërbime	26,000.00	26,000.00	25,077.70	922.30	922.30	96.45%
3	Subvencione	421,042.24	421,042.24	410,174.28	10,867.96	10,867.96	97.42%
4	Komunali	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
5	Shpenzime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
	<b>Gjithsej</b>	<b>528,490.16 €</b>	<b>528,490.16 €</b>	<b>516,144.90 €</b>	<b>12,345.26 €</b>	<b>12,345.26 €</b>	<b>97.66%</b>

Shpenzimet - Bujqësia 47033

Kodi	Përshkrimi	Shuma
11110	Paga neto	69,445.11
11500	Tatimi në paga	4,172.77
11600	Kontributi i punëtorit	3,633.47
11700	Kontributi i punëdhënsit	3,633.47
11115	Sindikata	8.10
	<b>Totali i pagave</b>	<b>80,892.92</b>
13430	Shërbime të ndryshme shëndetësore	353.39
13460	Shërbime kontraktuese tjera	10,509.72
13470	Shërbime teknike	1,199.00
13610	Furnizimi për zyre	577.50
13620	Furnizimi me ushqim dhe pije - jo dreka zyrtare	347.54
13950	Regjistrimi i automjeteve	105.00
13951	Sigurimi i automjeteve	240.72
14010	Mirembatja dhe riparimi i automjeteve	1,449.88
14032	Mirembatja e autorrugeve lokale	10,125.55
14040	Mirembatja e teknologjis informative	120.00
14310	Drekat zyrtare	49.40
	<b>Totali për shërbime mallra</b>	<b>25,077.70</b>
200	Subvencione	355,627.93
22300	Pagesa - vendime gjyqësore	54,546.35
	<b>Totali i subvencioneve</b>	<b>410,174.28</b>
300	investime kapitale	0.00
	<b>Totali i investimeve kapitale</b>	<b>0.00</b>
	<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>516,144.90 €</b>

Gjeodezi,kadaster,pron  
Kodi 65165

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	55,100.72	55,100.72	55,100.72	0.00	0.00	100.00%
2	Mallra dhe shërbime	15,100.00	15,100.00	14,446.50	653.50	653.50	95.67%
3	Subvencione	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
4	Komunal	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
5	Shpenzime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
	<b>Gjithsej</b>	<b>70,200.72 €</b>	<b>70,200.72 €</b>	<b>69,547.22 €</b>	<b>653.50 €</b>	<b>653.50 €</b>	<b>99.07%</b>

Shpenzimet - gjeodezi,kadaster,pron - 65165

Kodi	Përshkrimi	Shuma
11110	Paga neto	46,903.44
11500	Tatimi në paga	2,936.55
11600	Kontributi i punëtorit	2,623.81
11700	Kontributi i punëdhënsit	2,623.81
11115	Sindikata	13.11
	<b>Totali i pagave</b>	<b>55,100.72</b>
13134	Shp. te transportit per udhetime brenda vendit	1,781.00
13340	Shpenzimet per perdorimit e kabllit optik	400.00
13430	Shërbime te ndryshme shëndetësore	1,881.60
13460	Shërbime kontraktuese tjera	4,148.30
13470	Shërbime teknike	982.80
13503	Kompjuter	2,395.60
13610	Furnizimi per zyre	2,407.00
13620	Furnizim me ushqim dhe pije - jo dreka zyrtare	410.20
14040	Mirembajtja e teknologjis informative	40.00
	<b>Totali për shërbime dhe mallra</b>	<b>14,446.50</b>
200	Subvencione dhe transfere	0.00
	<b>Totali i subvencioneve</b>	<b>0.00</b>
300	Investime kapitale	0.00
	<b>Totali i investimeve kapitale</b>	<b>0.00</b>
	<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>69,547.22 €</b>

Planifikimi urban dhe mjedisi  
Kodi 660

Pasqyrat e ekeikutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	42,928.46	42,928.46	42,928.46	0.00	0.00	100.00%
2	Mallra dhe shërbime	27,000.00	27,000.00	25,253.81	1,746.19	1,746.19	93.53%
3	Subvencione	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
4	Komunali	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
5	Shpenzime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
	<b>Gjithsej</b>	<b>69,928.46 €</b>	<b>69,928.46 €</b>	<b>68,182.27 €</b>	<b>1,746.19 €</b>	<b>1,746.19 €</b>	<b>97.50%</b>

Shpenzimet - Planifikimi urban dhe mjedisi 660

Kodi	Përshkrimi	Shuma
11110	Paga neto	36,261.77
11500	Tatimi në paga	2,562.00
11600	Kontributi i punëtorit	2,044.24
11700	Kontributi i punëdhënsit	2,044.24
11115	Sindikata	16.21
